



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:190327

Datë: 13.01.2025

Numri i dokumentit: 06703991

**C.nr.1568/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil**, me gjyqtarin Nazmi Neziri, dhe procesmbajtësen Afërdita Ejupi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit 1. F. K. nr. personal ..., 2. B. Ç. nr. personal ..., 3. B. Ç. nr. personal ..., 4. T. Rr. nr. personal ..., dhe 5. L. G. nr. personal ..., të gjithë nga P., të cilët i përfaqëson i autorizuari M. P., avokat nga M., Rruga “Sh. A.” nr...., me autorizim, kundër të paditurës Komuna e Podujevës, Drejtoria e Arsimit nga Podujeva, Rruga “N. G.” pn., me objekt kontesti: Kompensimin e Gradimit-Kualifikimit profesional në pagën bazë, me vlerë të kontestit: 6,915.00 Euro (për të gjithë paditësit), jashtë seance me dt.13.01.2025, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**- pa shqyrtim kryesor të çështjes -**

**I. APROVOHET** pjesërisht kërkesëpadia e paditësit 1. F. K., 2. B. Ç., 3. B. Ç., 4. T. Rr., dhe 5. L. G., nga P., **si e bazuar**, dhe:

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Podujevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve secilit veç e veç, t’ia kompensojë dhe atë:

1. Paditësit F. K., në emër të kërkesës Mbi bazën e përgatitjes profesionale (kualifikimit), t’ia paguaj diferencën e shtesës në pagë në shumë mujore prej 51.66 €, (për periudhën nga muaji Korrik 2021 deri me dt.31.01.2023), gjegjësisht për 17 muaj, apo në shumën e përgjithshme prej 878.22 Euro.

**REFUZOHET** kërkesa e palës paditëse përtej shumës së aprovuar, shuma prej 505.53 €, **si e pa bazuar**.

2. Paditësit B. Ç., në emër të kërkesës Mbi bazën e përgatitjes profesionale (kualifikimit), t’ia paguaj diferencën e shtesës në pagë në shumë mujore prej 38.95 €, (për periudhën nga muaji Korrik 2021 deri me dt.31.01.2023), gjegjësisht për 17 muaj, apo në shumën e përgjithshme prej 662.15 Euro.

**REFUZOHET** kërkesa e palës paditëse përtej shumës së aprovuar, shuma prej 721.60 €, **si e pa bazuar**.

3. Paditësit B. Ç., në emër të kërkesës Mbi bazën e përgatitjes profesionale (kualifikimit), t'ia paguaj diferencën e shtesës në pagë në shumë mujore prej 55.35 €, (për periudhën nga muaji Korrik 2021 deri me dt.31.01.2023), gjegjësisht për 17 muaj, apo në shumën e përgjithshme prej 940.95 Euro.

**REFUZOHET** kërkesa e palës paditëse përtej shumës së aprovuar, shuma prej 442.80 €, **si e pa bazuar**.

4. Paditësit T. Rr., në emër të kërkesës Mbi bazën e përgatitjes profesionale (kualifikimit), t'ia paguaj diferencën e shtesës në pagë në shumë mujore prej 55.35 €, (për periudhën nga muaji Korrik 2021 deri me dt.31.01.2023), gjegjësisht për 17 muaj, apo në shumën e përgjithshme prej 940.95 Euro.

**REFUZOHET** kërkesa e palës paditëse përtej shumës së aprovuar, shuma prej 442.80 €, **si e pa bazuar**.

5. Paditësit L. G., në emër të kërkesës Mbi bazën e përgatitjes profesionale (kualifikimit), t'ia paguaj diferencën e shtesës në pagë në shumë mujore prej 55.35 €, (për periudhën nga muaji Korrik 2021 deri me dt.31.01.2023), gjegjësisht për 17 muaj, apo në shumën e përgjithshme prej 940.95 Euro.

**REFUZOHET** kërkesa e palës paditëse përtej shumës së aprovuar, shuma prej 442.80 €, **si e pa bazuar**.

**III. DETYROHET** e paditura Komuna e Podujevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve secilit veç e veç, shumat e përcaktuara sikurse në pikën II., të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ua paguaj me kamatë ligjore prej 8% duke filluar ti llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 372.00 Euro, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarimit.

### **A r s y e t i m**

Paditësi, në këtë gjykatë ka paraqitur padi kundër të paditurës për kompensimin në emër të kërkesave të përshkuara dhe shumën e përgjithshme, si në pjesën hyrëse të këtij aktgjykimi.

Ka shtuar se paditësi është në marrëdhënie të rregullt pune te e paditura dhe se e paditura përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të të drejtave të cilat rrjedhin nga Kontrata kolektive e Arsimit në Kosovë, konkretisht nenit 35 të saj dhe kontratës individuale dhe mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 të datës 05.10.2023, si dhe Vendimin të Qeverisë së Kosovës nr.01/33 të datës 29.08.2008, e paditura përkundër obligimit që rrjedh nga kjo bazë ligjore nuk ka bërë kompensimin në emër të kërkesave të paditësit siç janë precizuar.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurën që të bëjë kompensimin e shumës së precizuar në emër të kërkesave të lartcekura.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi, i ka pohuar faktet vendimtare duke theksuar se e konteston kërkesëpadinë e paditësit, për kompensimin në merë të kërkesave të tij. Ka theksuar se padia nuk ka bazë juridike, ngase me dispozitat kalimtare të kontratës kolektive në fuqi nga dt.18.04.2017, në nenin 46 të saj është paraparë se MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për t'i informuar dhe ndihmuar Komunitetet që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për pagesën e obligimeve që rrjedhin nga neni 35, andaj e paditura nuk ka buxhet për kryerjen e obligimeve ndaj punëtorëve. Ka shtuar se kjo kontratë kolektive sipas nenit 90.5 të ligjit të punës, vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me kontratën kolektive, e në rastin konkret e paditura nuk është nënshkruese kësaj kontrate.

Ka shtuar se paditësve duhet tu hiqen 5 muaj për shkak të parashkrimit. Paditëses F. K. diferenca mujore duhet ti paguhet nga 51.46 euro ngase pagën bazë e ka 393 euro, ndërsa paditësit B. Ç. diferenca mujore duhet ti llogaritet nga 38.95 euro kualifikimin e ka SHLP, dhe se kualifikimi duhet t'iu llogaritet deri me 31.01.2023.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim”*, lidhur me nenet 143 dhe 147 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se i padituri i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura me disa vite përvojë pune, po ashtu nuk është kontestuese se e paditura nuk i ka paguar paditësit kompensimin në emër të kërkesave të tij, pasi që një gjë e tillë nuk kontestohet nga palët, kjo vërtetohet dhe me provat materiale në shkresat e lëndës.

Andaj, gjykata, konform nenit 152 dhe 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke iu referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e dt.18.04.2017, konkretisht nenin 7 ku është përcaktuar se: *“Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi*

pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë::

1.1 Mësimdhënës me Shkollë Normale 10 % e pagës bazë.; 1.2 Mësimdhënës me Shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare 19% e pagës bazë.; 1.3 Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë; 1.4 Mësimdhënës me diplomë 5 vjeçar, magistraturë/master dhe doktoraturë 35% e pagës bazë.; 1.5 Përparimet në karrierë, caktohet lartësia e pagës dhe lëvizja në gradim që përcillet me ngritje page 10%.”, por këtë nuk e ka bërë e paditura edhe pse ka qenë e obliguar ta bëjë këtë.

Po ashtu kjo është e rregulluar me Ligjin nr.03/L-212 e Punës, sipas nenit 90 par.4 të tij ku thuhet se: “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se 3 ( tri) vjet.”, siç është e rregulluar dhe me dispozitat e nenit 7, 35 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë dhe Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë në fuqi nga data 22.01.2021 të cilat gjejnë zbatim në rastin e paditësit, si dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës GJ.A-Su.A.214/2023 të datës 05.10.2023, i cili në pikën I, ka paraparë se: “Për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008.”.

Gjykata lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë vendosi duke u bazuar në Kontratën e Punës Nr. protok.... të datës 01.09.2015, Diplomës universitare nr. ..., Licencës për mësimdhënës Nr. ..., Kontratën e Punës Nr. protok....të datës 01.10.2015, Diplomës universitare nr. ..., Licencës për mësimdhënës Nr. ..., Kontratën e Punës Nr. protok.... të datës 01.09.2015, Diplomës universitare nr. ... Licencës për mësimdhënës Nr. ..., Kontratën e Punës Nr. protok.... të datës 09.09.2018, Diplomës universitare nr. ..., Licencës për mësimdhënës Nr. ..., Kontratën e Punës Nr. protok.... të datës 01.09.2015, Licencës për mësimdhënës Nr. ..., Diplomës Universitare nr. ... Listës së pagës lëshuar nga Buxheti i Republikë së Kosovës në emër të paditësit, si provë, me ç ‘rast kemi të bëjmë me dokumente publike të cilat kanë fuqi të plotë provuese, e që në anën tjetër e paditura nuk i ka rrëzuar me prova materiale fuqinë provuese të këtyre dokumenteve, e gjithë kjo dhe bazuar në dispozitën e lart cituar të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, konkretisht nenit 7 të saj, nga data 22.01.2021, si dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/33 të datës 29.08.2008 dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës GJ.A-Su.A.214/2023 të datës 05.10.2023.

Përveç, kësaj lartësia e kërkesëpadisë është përcaktuar pjesërisht dhe nga përllogaritja e palës paditëse-të autorizuarit të tij të cilën e ka bërë në bazë të pagës bazë, siç shihet dhe nga provat e lartcekura dhe atë në shumën e përcaktuar dhe në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Këto përllogaritje për gjykatën kanë qenë të sakta dhe reale, ngase pala e paditur nuk ka pasur propozime për nxjerrjen e ndonjë prove për vërtetësinë e këtyre përllogaritjeve, kjo dhe nga fakti se shumatat e kërkuara janë vërtetuar dhe nga listat e pagave dhe një llogaritje e tillë për gjykatën, është llogaritje e thjeshtë matematikore.

Andaj, bazuar në këto përllogaritje gjykata ka aprovuar kërkesën e paditësit për periudhën kontestuese, shumën siç është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata i konsideron si të papranueshme dhe të pabazuara pretendimet dhe kundërshtimet e të paditurës se ajo nuk ka asnjë obligim ndaj paditësit me arsyetim se nuk ka buxhet për të bërë këto pagesa në emër të kërkesave të paditësit, se nuk është nënshkruese e kontratës dhe se paditësi nuk ka iniciuar procedurën administrative me kërkesë tek e paditura, për çka edhe i ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Ju refuzua kërkesa e paditësit përtej shumës së aprovuar në shumën si në dispozitiv si e pa bazuar, në emër të kompensimit shtesës mujore në bazë të përgatitjes profesionale (kualifikimit) dhe atë për periudhën kohore nga muaji Shkurt 2021 deri me 05.07.2021, për 5 muaj, meqë gjykata në kuptim të rrethanave të konstatuara me lart dhe duke e vlerësuar prapësimin e të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës, gjeti se kërkesa për këtë periudhë është e parashkruar. Kjo konform dispozitës së nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, (e cila dispozitë ka karakterin prekluziv) ku lidhur me kërkesat në para nga marrëdhënia e punës është paraparë afati i parashkrimit ashtu që është përcaktuar se: *”Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.”*, i cili afat në rastin konkret ka kaluar para se të jetë ngritur padia dhe atë nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive dt.18.04.2017 deri në ngritjen e padisë 05.07.2021, kanë kaluar mbi 3 vite me çka është parashkruar dhe kërkesa për realizimin e shtesës mujore në bazë të përgatitjes profesionale (kualifikimit) për këtë periudhë, konform dispozitave të lart cituara.

Po ashtu pjesërisht ju refuzua kërkesa për kualifikim për 1 muaj, për periudhën e kërkuar, ngase këtu nuk i llogaritet muaji Shkurt 2023, meqë paga për këtë muaj është realizuar sipas Ligjit të ri mbi pagat në sektorin publik (Nr. 08/L- 196), në bazë të cilit dhe është shfuqizuar vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/33 të datës 29.08.2008.

Ju refuzua kërkesa e paditësit F. K. dhe B. Ç., përtej shumës së aprovuar si e pa bazuar, dhe atë për periudhën kohore si në dispozitiv të aktgjykimit, përveç nga arsyet e dhëna edhe nga fakti se e njëjta ishte në kundërshtim me provat mbi bazën e të cilave iu është aprovuar shuma për kompensim dhe atë në veçanti në kundërshtim me Listën e pagave nga Buxheti i Republikës së Kosovës, ku shihet se paditësi ka kualifikimin me Fakultet Programit Parashkollor dhe se ka punuar Edukatore, ndërsa ka realizuar pagën bazë prej 393€uro, ( $393 \times 27\% = 106.11 - 54.45$  të cilat i ka realizuar = 51.66 €uro) e cila shumë 51.66€, mbetet për t’iu kompensuar paditësit, e jo shuma e kërkuar prej 55.35€. Ndërsa, paditësi B. Ç. ka kualifikim me Diplomë e Përgatitjes së Lartë Shkollore (SHLP), dhe të njëjtit i takon kompensimi sipas paragrafit 1 lidhur me par.4 pika 2) të Vendimit Nr. 01/33 të datës 20.08.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me 19% të pagës bazë, i cili ka realizuar pagën bazë prej 421€uro, ( $421 \times 19\% = 79.99 - 41.04$  të cilat i ka realizuar = 38.95 €uro) e cila shumë 38.95€, mbetet për t’iu kompensuar paditësit, e jo shuma e kërkuar prej 55.35€.

Kamatëvonesa është vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 382 të Ligji Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e palëve dhe provat tjera të ofruara, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes kontestimore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449, 450, 452 dhe 453.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore si dhe Rregullores për Tarifat e Avokatëve e Odës së Avokatëve të Kosovës (2017). Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara u referohet për përpilimin e padisë shuma prej 312 euro, si dhe taksave gjyqësore të paguara për padi në shumë prej 60 eurove, duke marrë për bazë vetëm ato shpenzime të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjykatë, suksesit në procedurë dhe lartësisë së aprovuar.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e cekura më lartë.

**Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.1568/2024, me datën 13.01.2025**

**Gjyqtari:**  
Nazmi Neziri

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.